



Nr. 685 Prot
dt: 17.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
Fakulteti Ekonomik

Nr. 685 Prot

Shkodër, më 17.02.2025

Lënda: Informim për të interesuarit për aplikim në programin e studimit "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"

**Rektorit të USH-së
Prof.dr. Tonin Gjuraj**

Referuar Urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nr.174 datë 04.04.2022 me subjekt "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" shkresë me nr. 1232/13 Prot fatë 23.09.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, me subjekt "Kthim përgjigje" mbi kuotat dhe udhëheqësit e programit Doktoratë. Vendimit të dekanatit Nr. 1626 Prot datë, 18.12.2024 "Mbi përcjelljen e kritereve të programit Doktoratë – Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për kuotat e vitit akademik 2023 – 2024, Vendimit Nr 1, datë 13.02.2025 të KDHGSHD, me Nr. 199 prot "Mbi konstituimin e komisionit të dhënies së gradës shkencore "Doktor" Feunishk, dhe vendimit Nr 2, datë 13.02.2025, me Nr. 200 prot "Mbi miratimin e tabelës së vlerësimit me pikëzim të dosjeve të aplikantëve për pranim në programin e studimit të ciklit të tretë doktoratë në: Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" FEUNISHK,

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju dërgojmë:

1. Vendimin e Konstituimit të KDHGSHD. Vendim Nr. 1, datë 13.02.2025, me Nr. 199 prot "Mbi konstituimin e komisionit të dhënies së gradës shkencore "Doktor" Feunishk,
2. Vendimin e miratimit të tabelës së vlerësimit të dosjeve aplikuese. Vendimit Nr 2, datë 13.02.2025, me Nr. 200 prot "Mbi miratimin e tabelës së vlerësimit me pikëzim të dosjeve të aplikantëve për pranim në programin e studimit të ciklit të tretë doktoratë në: Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" FEUNISHK.

Kërkojmë nga ana juaj publikimin në faqen zyrtare të universitetit për informim për të interesuarit për aplikim në programin e studimit "Doktoratë" në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm.

Kjo shkresë Përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë



Dekani
Prof.dr. Elidiana Bashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 199 Prot

Shkodër, më 19.02.2025

V E N D I M

Nr. 1 , datë 13.02.2025

**“MBI KONSTITUIMIN E KOMISIONIT TË DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE
‘DOKTOR’ TË FEUNISHK**

Në mbështetje të Ligjit me Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; Statutit të USH; Ligjit nr.8480 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; Urdhërit nr.174, datë 4.4.2022 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në ‘Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm’”; vendimit të marrë nga asamblea akademike të FEUNISHK në mbledhjen e datës 13.01.2024 me shkresën nr.55 prot, datë 15.01.2025 mbi “Krijimin e Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore Doktor në FE”, anatarët e zgjedhur të KDHGSHD të FEUNISHK në mbledhjen e parë me datën 13.02.2025 me shumicë votash

VENDOSËN:

1. Konstituimin e Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore Doktor (KDHGSHD) të FEUNISHK.
2. Miratimin e Prof.as.Dr.Elidiana Bashi kryetare të KDHGSHD të FEUNISHK.
3. Miratimin e Prof.as.Dr. Mirjam Dibra sekretare e KDHGSHD të FEUNISHK
4. Ky vendim t’i vihet në dijeni Rektorit të USH.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare
Prof.as.dr.Elidiana Bashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 200 Prot

Shkodër, më 14.02 .2025

V E N D I M

Nr. 2 , datë 13.02.2025

"MBI MIRATIMIN E TABELËS SË VLERSIMIT ME PIKËZIM TË DOSJEVE TË APLIKANTËVE PËR PRANIM NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË: EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM"

Në mbështetje të ligjit me Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; aktet nënligjore në fuqi për programet e ciklit të treta të studimeve doktoriale; Urdhërin Nr.174, datë 4.4.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për 'Hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në 'Ekonomi dhe Turizëm I qëndrueshëm'; të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi; Vendimit të Senatit Akademik të USH nr.23 datë 24.01.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores për organizimin e programeve të Doktoraturës në USH"; të Rregullores së Studimeve në USH, e ndryshuar; Rregullores së Fakultetit Ekonomik të USH; Rregullores së studimeve në programin e ciklit të tretë të studimeve të Doktoraturës në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm'; në vendimin e Dekanatit të FE me Nr.50 datë 18.12.2024, Nr. 1625 Prot. me subjekt "Mbi miratimin e kriterëve të pranimit në programin Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm", anëtarët e KDHGSHD të FEUNISHK shqyrtuan në mbledhjen e datës 13.02.2025, vlerësimin me pikëzime të dosjes të aplikantëve për pranimit në Doktoraten "Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm" dhe me shumice votash

VENDOSËN:

1. Miratimin e tabelës së vlerësimit me pikëzime të dosjes së aplikantëve për pranimit në programin e studimit Doktoratë në 'Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm' sipas tabelës së bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare

Prof.as.dr.Elidiana Basha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK

Tabela e vleresimit me pikëzim të dosjeve të aplikantëve për pranim në programin e Doktoratës 'Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm'

1. Nota mesatare vlerësohet maksimalisht me **50 pikë**, ku 25 pikë maksimale janë për programin Bachelor dhe 25 pikë maksimale janë për programin Master shkencor, Master of Arts, duke filluar nga 5 pikë nota 8 (tetë) dhe për cdo 0.1, shtohet 1 pikë si më poshtë:
 - a) 8 **5 pikë**
 - b) 9 **15 pikë**
 - c) 10 **25 pikë**
2. Vlersimi i projekt-propozimi të kërkimit sipas formatit të bashkëngjitur: **0-40 pikë**
 - a) Përputhja e çështjes së zgjedhur si problem kërkimor me një nga projektet kërkimore-zhvillimor të Doktoratës (**0-10 pikë**)
 - b) Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (**0-10 pikë**)
 - c) Originaliteti i punimit (**0-10 pikë**)
 - d) Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme) (**0-10 pikë**)
3. Eksperienca akademike dhe kërkimore shkencore (1 pikë për cdo vit) **0-10 pikë**
TOTALI max **100 pikë**

Vlersimi i prioriteteve në pranim të kandidatëve aplikant

1. Personeli akademik me kohë të plotë i Fakultetin Ekonomik të USH (**Totali i pikëve x 2**)
2. Personel akademik me kohë të pjeshme i Fakultetit Ekonomik të USH (**Totali i pikëve x 1.9**)
3. Personeli akademik me kohë të plotë në Departamentet e Fakulteteve të tjera të USH (**Totali i pikëve x 1.7**)
4. Personeli akademik me kohë të pjeshme në Departamentet e Fakulteteve të tjera të USH (**Totali i pikëve x1**)
5. Personeli akademik me kohë të plotë të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera, publike dhe jopublike (**Totali i pikëve x1**)
6. Personeli akademik me kohë të pjeshme të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera, publike dhe jopublike (**Totali i pikëve x1**)
7. Personeli akademik/kërkimor në Universitete të tjera, dhe të institucioneve ose organizatave publike dhe jopublike që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të Doktoraturës (**Totali i pikëve x 1**)

Kryetare

Prof.as.dr.Elidiana Bashi

